

## KONTRATE SHITJE KUOTASH



Lidhur sot më datë 23/10/2024 ndërmjet palëve:

**PALA SHITËSE : Z. ANDI HODAJ** i datëlindjes 28 Shtator 1980 shtetas shqiptar me nr. personal I00928175R lindur dhe banues në Vlorë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ortak i vetëm i shoqërisë **VILLA SOL sh.p.k.** me NIPT **L77021201T**

**PALA BLERËSE:** Znj. **DARIA KHOTEEVA** e datëlindjes 20 Janar 1985 shtetase ruse, mbajtëse e dokumentit të identifikimit pasaportë me numër **76 0176642** lindur dhe banuese në Moskë ( Rusi ), gjithashtu pajisur me leje qëndrimi me nr.281757 dhe me numër personal I58120006T , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

### *Kushtet e kontratës*

- 1.Ortaku i vetëm i shoqërisë VILLA SOL sh.p.k. me NIPT L77021201T i shet znj. DARIA KHOTEEVA pjesën prej 100% të kapitalit që ai zotëron në shoqërinë VILLA SOL sh.p.k. me një cmim prej 100.000 lekë.
- 2.Pala shitëse deklaron se ka marrë plotësisht cmimin e mësipërm prej palës blerëse përpara nënshkrimit të kësaj kontrate. Pala shitëse deklaron se kuotat e shoqërisë VILLA SOL sh.p.k. janë të lira nga cdo barrë, sekuestro apo peng.
- 3.Efektet e cedimit do të fillojnë pas depozitimit të praktikës në QKB dhe me realizimin e shitjes së kuotave, blerësi Znj. **DARIA KHOTEEVA** , bëhet ortak i vetëm i shoqërisë me 1 kuotë në masën **100 %** me vlerë **100.000** lekë.

Të pranishmit e lexojnë aktin dhe e nënshkruajnë pa vërejtje e me vullnet të lirë.

PALA SHITËSE

Andi Hodaj



PALA BLERËSE

Daria Khoteeva